

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

**Auditim i avancuar dhe  
siguria  
(zgjidhjet)**

**P10**

Data 10/07/2020

## **Detyra 1**

Ju jeni një menaxher i auditimit në firmën e auditorëve C&G dhe sapo jeni kthyer nga pushimet. Pas kthimit tuaj, drejtori juaj ju ka informuar se do të punoni në auditimin e Glamour Fashion (GF) për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019.

Ju jeni shumë të emocionuar për këtë mundësi pasi keni një interes të madh për modën. Partneri i angazhimit të auditimit është Pal Kemaj.

### **Hyrje**

Laura Fllanza zotëron 60% të aksioneve të zakonshme në GF dhe burri i saj Samiu, zotëron aksionet e mbetura. GF dizenjon, prodhon dhe shet veshje në Kosovë dhe Shqipëri. Kompania shet veshjet e saj në internet dhe përmes dyqanit të saj, i cili u hap në qershor 2019. Për më tepër, GF ka një kontratë tre-vjeçare për të shitur veshjet e saj të stilistëve tek Vina Tres Store (VTS), një shitës me pakicë i madh përmes faqes së internetit. Klientët e GF të porosisin veshje në internet nga komoditeti i shtëpisë së tyre, si dhe mund të bashkangjiten klubit të anëtarësisë VIP të kompanisë. Anëtarët e klubit të anëtarësisë VIP paguajnë një parapagim vjetor, për të cilin marrin oferta ekskluzive dhe zbritje gjatë gjithë vitit.

### **Të hyrat**

Kontrata i siguron ADS ekskluzivitet, i cili ndalon GF të furnizojë linjat e veshjeve të stilistëve të shitësit tjerë me pakicë. Të hyrat e krijuara nga kontrata janë afërsisht 20% të të hyrave totale të GF, dhe GF arrin një marzh fitimi bruto prej 25% në këto shitje. Kontrata pritet të rinovohet më 30 qershor 2020. ADS i ka shkruar GF duke deklaruar se beson se hapja e dyqanit të ri të GF është shkelje të marrëveshjes së ekskluzivitetit.

### **Lokalet e reja**

Blerja e lokaleve dhe pajisjeve për dyqanin e ri u financua nga një hua pesë-vjeçare nga banka e kompanisë e cila kërkon që GF të përmbushë marrëveshjet e kredisë të përcaktuara në marrëveshjen e kredisë. Çdo shkelje e kushteve të kredisë do të rezultojë që kredia të shlyhet/kthehet menjëherë.

### **Granti qeveritar**

GF mori një grant prej 350,000 € si ndihmë nga një agjenci qeveritare në qershor 2019 për blerjen e pajisjeve të reja gjatë vitit (me një jetë të dobishme të prishme prej 10 vjetësh). Ky grant ishte i kushtëzuar me krijimin e 10 pozicioneve të reja të punës për tu krijuar në GF deri më 31 Dhjetor 2019. Në 31 Dhjetor 2019, GF ishte në gjendje të punësonte vetëm 5 anëtarë të rinj të stafit. GF nuk ka pasur asnjë korrespondencë me agjencinë qeveritare që kur granti u mor në qershor 2019.

### **Stoqet**

Siç u tha më lart, GF dizenjon dhe prodhon të gjitha veshjet e saj në fabrikën në Prishtinë, duke përdorur materiale të cilësisë së lartë. Për të shmangur çregullimin gjatë numërimit të stoqeve në fund të vitit, GF, ka prezantuar këtë vit një sistem të vazhdueshëm / të përhershëm të numërimit të stoqeve.

Në fund të vitit, është propozuar që stoqet të bazohet në regjistrat themelore.

Shihni Shtojcën 1, për detaje të shënimeve të marra në takimin e planifikimit me Laura dhe Samiun, Palin dhe menaxherin e auditimit.

### **Shtojca 1: Takimi i planifikimit:**

Më 10 shkurt 2020, si pjesë e planifikimit të auditimit, ju u takuat me Laurën dhe Samiun të cilët theksuan sa vijon:

(1) GF po paditet nga një konkurent i cili pretendon se një nga gamat e reja të veshjeve të GF, 'DESIGNFX', ka shkelur markën tregtare në pronësi të konkurrencës për atë emër marke.

Rezultati i pretendimit nuk do të dihet deri pas nënshkrimit të raportit të auditimit.

(2) GF blen materialet e saj luksoze në shkallë ndërkombëtare; megjithatë, furnizuesi i tij kryesor, BMK, ndodhet në Nju Jork. Të gjitha blerjet nga BMK faturohen dhe paguhet në dollarë amerikanë. Për shkak të luhatjeve në kursin e këmbimit valutor midis Euro € dhe US \$, kostoja e materialeve nga Nju Jorku është rritur ndjeshëm. Prandaj Laura po përpiqet të sigurojë materiale në Kosovë; megjithatë, ajo shqetësohet për cilësinë e materialeve dhe beson se ato mund të komprometohen

(3) Gjatë nëntorit 2019, GF ishte temë e reklamave të pafavorshme në lidhje me cilësinë e gamës më të fundit të veshjeve, 'LM LUXE'. Si rezultat, GF ka vendosur të shesë këtë gamë të veçantë veshjesh me një zbritje prej 50% në shitjen e janarit.

(4) Drejtorët përgatitën pasqyrat financiare për vitin e plotë që përfundon më 31 dhjetor 2019 dhe kanë dhënë përmbledhjen më poshtë. Laura shpjegoi se ndryshimi midis performancës aktuale dhe të buxhetit ishte për shkak të kostove më të larta se sa pritej për interesin e huasë bankare dhe kostove administrative të pa buxhetuara që lidhen me funksionimin e dyqanit të ri.

	Aktuale 31 dhjetor 2019	Buxheti 31 dhjetor 2019	Aktuale 31 dhjetor 2018
Të hyra	9,600	11,700	10,800
Fitimi	345	702	1,200

**Kërkohet:**

(a) Hartoni një memo për partnerin e auditimit i cili:

(i) Vlerëson në mënyrë kritike GJASHTË **rreziqet kryesore** të auditimit që dalin nga të gjitha informacionet e dhëna; dhe (12 pikë)

(ii) Për secilin rrezik, përshkruani **procedurat** që duhet të përfshihen në planin e auditimit për të adresuar atë rrezik. (12 pikë)

1 pikë për format

**[Gjithsej: 25 pikë]**

## Zgjidhja

Faktorët e rrezikut të auditimit	Plani i auditimit
<p><b>Paragjykimet e menaxhmentit dhe dyshimet për integritetin e menaxhmentit</b></p> <p>Kredia bankare ka kushte të cilat, nëse shkelen, do të rezultojnë me ripagimin e menjëhershëm të kredisë. Prandaj drejtorët mund të kenë motiv që të prezantojnë pasqyrat financiare në atë mënyrë që të përmbushin ato kushte të kredisë.</p>	<p>Duhet të kemi vëmendje të shtuar lidhur me fushat që janë më subjektive dhe kërkojnë gjykime nga menaxhmenti siç janë provizionet, vlerësimi i stoqeve, prerja dhe njohja e të hyrave.</p> <p>Rillogaritni kredinë bankare dhe rioshikoni nëse kushtet e kredisë janë të rrezikuara nga shkelja.</p> <p>Inspektoni korrespondencat me bankën e kompanisë për tu siguruar nëse nuk ka çështje që çojnë në drejtim të shkeljes së kushteve apo kërkesës për ripagim të menjëhershëm të kredisë.</p>
<p><b>Çështjet me hipotezën e vijmësisë</b></p> <p>Kompania mund të mos jetë në gjendje të vijojë sipas hipotezës së vijmësisë për shkak të një numri të faktorëve:</p> <p>Kompania shet roba të dizajnerëve prandaj shitjet mund të ndikohen nga publiciteti i kundërt për shkak të cilësisë së rrobave. Performanca e kompanisë deri me sot ka qenë e dobët: të hyrat e parashikuara janë 18% më të ulëta se buxheti dhe 11% më të ulëta se vitin e kaluar dhe marzha bruto ka rënë nga 11% në 2018 në 4% të të hyrave të parashikuara në 2019.</p> <p>Kontrata me ADS do të rinovohet me 30 qershor 2020. Rinovimi i kontratës duket se nuk do të ndodhë për shkak të pretendimeve nga ADS se GF është duke shkelur kushtet e kontratës me hapjen e dyqanit të ri. Humbja e kontratës do të rezultonte me humbje të të hyrave prej 20% që do të thotë se GF do të gjeneronte humbje.</p> <p>GF gjithashtu është duke u paditur nga një konkurent duke pretenduar se është duke shkelur të drejtat e markës tregtare. Rezultati i këtij rasti nuk dihet dhe mund të shkaktojë vështirësi financiare për GF nëse do të detyrohej të paguante gjoba.</p> <p>GF është duke u mbështetur shumë në një furnitor të vetëm për material.</p>	<p>Merrni pasqyrat financiare me anë të kompanisë për të kontrolluar performancën e kompanisë pas fundit të vitit.</p> <p>Merrni parashikimin e parasë për 12 muajt e ardhshëm për të identifikuar nëse GF mund të paguarj borxhet e saj.</p> <p>Kryeni një analizë të sensitivitetit në rreth të parasë nëse do të tërhiqej kredia e bankës dhe nëse do të ndërpritej kontrata me ADS.</p> <p>Diskutoni me menaxhmentin nëse do të ndikohen shitjet nga publiciteti i kundërt dhe anëtarësimet e fshehta në klub.</p> <p>Inspektoni kontratën me ADS lidhur me kushtet dhe ekskuluzivitetin për tu siguruar nëse ka ndodhur shkelja e kontratës.</p> <p>Inspektoni korrespondencat me ADS lidhur me rinovimin e kontratës si dhe korrespondencat me juristët e kompanisë lidhur me gjasën se shkeljes së kontratës.</p> <p>Inspektoni pasqyrat financiare për shpalljet e pasigurive</p> <p>Përftoni përfaqësimet e menaxhmentit lidhur me planet e fizibilitetit të kompanisë</p> <p>Diskutoni me menaxhmentin për planet për blerjen e materialeve për shkak të implikimeve me kursin e këmbimit valuator.</p>
<p><b>Njohja e të hyrave</b></p> <p>GF realizon një pjesë të madhe të të hyrave online përmes uebfaqes prandaj ka rrezik që shitjet nuk janë regjistruar saktë në sistemin e kontabilitetit nga uebfaqja. Të hyrat që</p>	<p>Testoni procedurat e kontrollit lidhur me regjistrimin e shitjeve online</p> <p>Përzgjedhni një mostër të parapagimeve/anëtarësimeve dhe sigurohuni</p>

<p>realizohen nga parapagimet bjetore ne klubin secret të anëtarëve dhe kontrata trevjeçare me ADS, mund të mos jene të njohura në periudhat e duhura kontabël</p> <p>Kthimet e mallrave dhe kreditimet për parapagimet e anuluar mund të mos jenë trajtuar si duhet</p> <p>Hapja e dyqanit të ri do të thotë se GF do të realizoj të hyra me para të cilat janë të ndjeshme ndaj keqpërdorimit – SNA 240 rreziku i mashtrimit.</p>	<p>se të hyrat e njohura në vit përputhen me ofrimin e dhuratave ndaj konsumatorëve</p> <p>Rillogaritni çfardo të hyre të shtyrë për një mostër dhe ndjekni ato deri te shifra totale në PF</p> <p>Merrni një kopje të kontratës me ADS për të kutpuar se si gjenerohen të hyrat përgjatë periudhës së kontratës dhe krahasoni ato me të hyrat e njohura në PF</p> <p>Përzgjedhni një mostër të parapagimeve të anuluar dhe testoni për trajtimin e duhur të tyre</p> <p>Identifikoni dhe testoni procedurat e kontrollit rreth shitjeve me para në dyqanin e ri</p>
<p><b>Këmbimi valuator – gabimet me përkthimet</b></p> <p>Blerjet, stoqet dhe të pagueshmet mund të mos jenë paraqitur saktë për shkak të gabimeve në përkthim të valutave gjatë blerjeve të materialeve në SHBA</p>	<p>Përputhni normat e këmbimit që janë zbatuar me një burim të pavarur (psh banka)</p> <p>Rikalkuloni një këmbim valuator të një mostre të blerjeve</p>
<p><b>Stoqet dhe vlera neto e realizueshme</b></p> <p>Prodhimi dhe dërgesa e mallrave të gatshme do të vazhdoj edhe gjatë numërimit të fundvitit që do të rritë rrezikun që të mos numërohen si duhet</p> <p>GF operon në një industri që ndryshon në mënyrë konstante për shkak të ndryshimeve në modë. Gjithashtu vendimi për të shitur disa mallra me 50% zbritje në janar mund të ndikojë që kosto e stoqeve në fund të vitit të mos jetë e saktë duke mos u përfshirë me vlerën neto të realizueshme sipas SNK 2</p>	<p>Merrni pjesë në numërimin fizik të stoqeve dhe vëzhgoni efektivitetin e kontroleve mbi dërgesën e mallrave të gatshme dhe lëvizjen e lëndës së parë përbrenda kompanisë.</p> <p>Kryeni testet e kontrollit në numërimin e fundvitit dhe krahasoni sasitë e stoqeve fizike me ato nga sistemi i përherëshëm dhe hetoni mospërputhjet. Merrnjë mostër të stoqeve dhe tesoni nga depo në lista për të testuar plotësinë e stoqeve në fund të vitit.</p> <p>Inspektoni një mostër artikujve të ‘LM-LUXE’ në fund të vitit dhe kërkoni shitjet e tyre pas fundit të vitit për tu siguruar se artikujt janë përfshirë me kosto ose VNR cilado që është më e ulët ne pajtueshmëri me SNK 2</p> <p>Vërtetoni sasinë e stoqeve që janë specifike me brandin “DESIGNFX”</p> <p>Kryeni testimin e prerjes duke krahasuar faturat me fletëdërgesat dhe fletëpranimet në datat afër fundit të vitit</p>
<p><b>Detyrimet dhe kosto e financimit</b></p> <p>GF ka marr një kredi të re në mes të vitit për dyqanin e ri. Kredia është për një afat më të gjatë se një vit prandaj saldoja e mbetur duhet të ndahet në mes të pjesës afatgjatë dhe afatshkurt</p> <p>Kosto e financimit mund të jetë llogaritur gabimisht</p>	<p>Përputhni shumën e kredisë së pranuar nga banka me gjendjen e bankës</p> <p>Inspektoni PF për klasifikim të duhur të pjesës afatgjatë dhe afatshkurt</p> <p>Rillogaritni interesin e ngarkuar bazuar në marrëveshjen për kredi dhe krahasoni me shumën ne pasqyrën e të ardhurave</p>
<p><b>Detyrimet e paregjistruara dhe detyrimet kontingjente</b></p> <p>GF është duke u paditur nga një konkurent lidhur me shkeljen e mundshme të markës tregtare. Rezultati i kësaj padie nuk do të</p>	<p>Diskutoni me menaxhmentin se si ata planifikojnë të trajtojnë këtë çështje</p> <p>Konsideroni përshtatshmërinë e propozimit të menaxhmentit</p> <p>Inspektoni PF për shpalesjet e duhura</p>

<p>dihet deri pas përfundimit të raportit të auditimit</p> <p>Nëse hapja e dyqanit të ri është shkelje e kontratës me ADS kjo mund të rezultoj me ndëshkime që duhet të njihen ose shpalosen varësisht nga rezultati i pritur.</p>	
<p><b>Transaksionet me palët e lidhura</b></p> <p>Drejtorët zotërojnë 100% të aksioneve të GFprandaj janë palë të lidhura me kompanisë</p>	<p>Biseoni me menaxhmentin se cilat transaksione kanë ndodhur në mes të aksionarëve dhe kompanisë</p> <p>Inspektoni procesverbalet e takimit të bordit për çfardo dëshmie për palë të lidhura</p> <p>Kërkoni përfaqësimet e menaxhmentit se të gjitha transaksionet me palët e lidhura janë trajtuar si duhet dhe janë shpalosur.</p>
<p><b>Grantet qeveritare</b></p> <p>Grantet nuk janë trajtuar si duhet ose kushtet lidhura me grantin mund të jenë shkelur që do të shkaktonte tërheqjen e grantit nga agjencia</p>	<p>Përftoni dhe rishikoni kushtet e grantit</p> <p>Verifikoni përmes rishikimit të kontratave të punësimit dhe regjistrimit të rrogave se janë punësuar 5 persona</p> <p>Bisedoni me menaxhmentin nëse kanë pranuar ndonjë korrespondencë me agjencinë dhe nëse nuk janë plotësuar kushtet e grantit</p> <p>Propozoni korrigjimet në PF nëse është e nevojshme</p>

## Detyra 2

Klienti juaj, Dig SHA, është prodhues i makinerive që përdoren në industrinë e prodhimit të energjisë.

Ju jeni aktualisht duke planifikuar auditimin e pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 30 nëntor 2020. Pasqyrat draft financiare tregojnë të hyra prej €125 milion (2019 – €103 milion), fitim para tatimit prej €5.6 milion (2019 – €5.1 milion) dhe pasuritë total prej €95 milion (2019 – €90 milion).

Firma juaj është caktuar si auditor i Dig sh.p.k për herën e parë në qershor 2020.

Dig SHA dizajnon, ndërton dhe instalon makineri për pesë klientët kyç. Pagesa duhet kryer në tri këste: 50% duhet të kryhet kur konfirmohet porosia (faza 1), 25% në dërgesën e makinerisë (faza 2) dhe 25% në instalimin e sukseshëm të makinerisë te klienti (faza 3). Në përgjithësi nevojiten 6 muaj nga finalizimi i porosisë deri tek instalimi final.

Më 30 nëntor, ka një shumë të papaguar prej €2.85 milion nga Arti sh.p.k. Shuma është duke u kundërshtuar nga klienti dhe i takon pagesës së fazës së tretë. Arti sh.p.k refuzon të paguajë deri sa makineria e cila është instaluar në gusht 2020, të funksionojë me efikasitet 100%.

Një klient, Sali shpk, me të cilin është komunikuar në nëntor 2020, përmes avokatëve të tij me Dig shpk, ka pretenduar për dëmet e shkaktuara nga lëndimet e pësuar nga një operator i makinerisë, krahu i të cilit u plagos rëndë kur një makinë u prish. Armend Keli, drejtor ekzekutiv i Dig shpk, ju ka treguar juve se dëmi është duke u injoruar pasi që Sali shpk është i njohur për sigurinë e ulët në punë dhe për këtë shkak aksidenti është faji i tyre. Dy porositë e bëra nga Sali shpk në tetor 2020 janë anuluar.

Puna në progres është vlerësuar me €8.5 milion në 30 nëntor 2007. Numërimi fizik i stoqeve është bërë më 17 nëntor 2020. Shefi i inxhinjerëve ka vlerësuar fazën e kompletimit të secilës makineri në atë datë.

Njëri nga komponentët i përfshirë në makinerinë për prodhimin e energjisë tani është duke u marrë nga jashtë vendit. Furnitori i ri, EngCorp, është i vendosur në Amerikë dhe e faturon DIG shpk në dollar.

Ka të pagueshme tregtare prej €1.5 milion borxh ndaj EngCorp të cilat janë regjistruar në detyrimet afatshkurta.

Të gjitha makieritë janë blerë me garanci prej 1 viti. Provizionet për garanci në shumë prej €2.5 milion (2019 – €2.4 milion) njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Armend Keli vlerëson koston e riparimit të makinerive me defekte të raportuara nga klientët dhe me këtë vlerësohet forma e bazës së provizionit.

Armend Keli ka në pronësi 60 % të aksioneve të DIG shpk. Ai poashtu ka në pronësi 55% të Pacifik shpk, kompani kjo që i ka lëshuar me qera ndërtesën për zyret qendrore të DIG shpk. Blerta është duke konsideruar të shet disa aksione të saj në DIG shpk në muajin janar 2021 dhe do të dëshironte që të përfundojë auditimi deri në atë kohë.

### **Kërkohet:**

(a) Duke përdorur informatat e dhëna, identifikoni dhe shpjegoni rreziqet kryesore të auditimit dhe çështje të tjera të cilat duhet të merren në konsiderim kur të planifikohet auditimi final i DIG ShPK për vitin që përfundon më 30 nëntor 2020.

Shënim: përgjigja juaj duhet të paraqitet në formatin e memos e cila duhet të përdoret në takimin për planifikim. Kërkesa (a) përfshin 2 pikë profesionale. (13 pikë)

(b) Shpjegoni procedurat kryesore të auditimit të cilat duhet të kryhen gjatë auditimit final në lidhje me çështjen e vlerësimit të provizioneve për garancitë në pasqyrën e pozicionit financiar të DIG shpk më 30 nëntor 2020.

(5 pikë)

(c) (i) Identifikoni dhe përshkruani KATËR procedura të kontrollit të cilësisë që janë të zbatueshme në angazhimin e auditimit; dhe (8 pikë)

(ii) Diskutoni DY probleme me të cilat mund të ballafaqohen gjatë zbatimit të procedurave të kontrollit të cilësisë në një firmë të vogël të auditimit dhe rekomandoni se si mund të tejkalohen këto probleme. (4 pikë)

### [Gjithsej: 30 pikë]

Zgjidhja

(a) Shënimet shpjeguese

Subjekti Rreziqet kryesore të auditimit-DIG shpk

#### **Njohja e të hyrave - koha**

DIG shpk lëshon fatura në tri faza. Ekziston mundësia për shkelje të SNRF 15 *Të hyrat nga kontratat me konsumatorët* i cili kërkon që të hyrat duhet të njihen atëherë kur shitësi ka të drejtë t'i arkëtojë, më fjalë të tjera kur shitësi i ka kryer obligimet e veta kontraktuale. Kjo e drejtë nuk korrespondon domosdoshmërisht me shumat në rrënie për pagesa në përputhje me faturat e dakorduara me klientët si pjesë e kontratës.

Kompania duket të arkëtojë pagesat nga klientët në avans para se të kryejë obligimet pasi që fatura e fazës së parë lëshohet kur porosia konfirmohet p.sh. para se të kryhet ndonjë punë. Kjo krijon potencial që të hyrat të njihen shumë më heret, në avans të cfarëdo pune të kryer sipas obligimeve kontraktuale. Kur pagesa arkëtohet në avans para performancës, duhet të njihet një detyrim i barabartë me shumën e arkëtuar, që paraqet obligimet nga kontrata. Andaj eksiton një rrezik i madh që të hyrat janë të mbivlerësuara dhe detyrimet të nënvlerësuara.

#### **Të arkëtueshmet e dyshimta**

Shuma e cila është e papaguar nga Arti shpk është shumë materiale pasi që paraqet 50.9% të fitimit para tatimit, 2.3% të të hyrave dhe 3% të pasurive në total. Rreziku është që të arkëtueshmet janë të mbivlerësuara nëse nuk bëhet shlyerja e arkëtueshmeve të dyshimta të cilat janë njohur në pasqyrat financiare.

#### **Provizionet për dëme**

Dëmi duhet të hulumtohet serozisht nga DIG shpk. Mendimi i shefit ekzekutiv që dëmi nuk do të ketë pasoja financiare për DIG shpk mund të jete i gabuar. Dëmet mund të jenë përgjegjësi e DIG shpk nëse kuptohet se makineria ka qenë shkaktare e dëmit.

Niveli i lartë i provizioneve për garancitë tregon që fajet e makinerive janë të zakonshme dhe aksidenti do të mund të jetë rezultat i makinerisë me defekte e cila i është shitur Sali shpk. Rreziku është se nuk janë ndarë provizione për dëmet potenciale në përputhje me SNK 37 Provizionet, Detyrimet Kontingjente dhe Pasuritë Kontingjente nëse ka shumë gjasa se do të ndodhin pagesa të dëmeve.

Në të kundërtën, nëse gjasat për pagesën e dëmeve janë të vogla atëherë kjo gjë duhet të shpaloset në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare duke përshkruar natyrën dhe efektet e mundshme financiare të detyrimit kontingjent. Sic u diskutua më lartë, shefi ekzekutiv ka mendimin se nuk duhet të ndahet provision ose të shpalosen detyrimet kontingjente për shkak të shitjes së planifikuar të aksioneve pas fundit të vitit.

Një rrezik i mëtutjeshëm është që cdo shpenzim ligjor që lidhet me dëmin nuk është njohur si shpenzim aktual në pasqyrat financiare. Pasi që dëmi është paraqitur gjatë vitit, shpenzimet duhet të përfshihen në pasqyrën e të ardhurave të këtij viti, edhe pse dëmi është ende duke ekzistuar në fund të vitit.

Fakti që dëmi ligjor është efektivisht duke u injoruar mund të shkaktojë dyshime në integritetin e menaxhmentit senior dhe në integritetin e pasqyrave financiare. Përfaqësimeve të menaxhmentit duhet tu qasemi me një masë të skepticizmit profesional gjatë auditimit.

Sali shpk ka anuluar dy porositë. Nëse shumat janë ende të papaguara në fund të vitit atëherë ka shumë gjasa që Sali nuk do t'i paguajë shumat e faturuar dhe të arkëtueshmet do të jenë të mbivlerësuara. Nëse pagesat e fazës së parë janë bërë, atëherë Sali mund të kërkojë rikthim. Në raste të tilla duhet të njihet një provizion për të ripaguar shumat ose një detyrim kontingjent duhet të shpaloset në shënimet e pasqyrave financiare.

Sali është njëri ndër pesë klientët kyc dhe humbja e këtij klienti mund të ketë problem të mëvonshme me hipotezën e vijimësisë për DIG shpk, nëse nuk mund të gjendet burim tjetër i të hyrave që do të mund të zëvendësojë të hyrat e humbura nga Sali. Nëse dëmi ligjor bëhet publik dhe DIG shpk gjendet fajtor sepse ka shitur makineritë, pastaj do të jetë e vështirë që të gjenden klientë të rinj.

Një rast i kësaj natyre do të mund të shkaktojë renome jo të mirë të DIG shpk, pastaj ceshtjen e moszbatimit të hipotezës së vijimësisë nëse rezultohet që ndonjëri nga pesë klientët kyc të DIG shpk të ndërprejë kontratën e këtij kompani.

Auditorët duhet të planifikojnë programin e vazhdimin të hipotezës së vijimësisë duke inkorporuar ceshtjet e paraqitura më lartë.

### **Stoqet**

Puna në progres është materiale në pasqyrat financiare, duke paraqitur 8.9% të pasurive në total. Numërimi fizik i stoqeve është bërë dy javë para fundvitit. Ekziston rreziku që nuk është bërë vlerësimi i duhur në pasqyrën e pozicionit financiar

Rreziku kyc është vlerësimi i fazës së kompletimit të punës në progres. Kjo është subjektive dhe njohuria duket se vjen nga inxhinjeri kryesor. Stoqet mund të jenë të mbivlerësuara nëse makineritë vlerësohen se janë më shumë të kompletuara sesa janë në aktualisht në fund të vitit. Përvetësimi i kostove të punës dhe shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit në secilën makineri është kalkulim kompleks dhe duhet të jetë konsistent me vitet paraprake.

Do të jetë poashtu me rëndësi se stoqet e materialeve harxhuese të cilat nuk janë përdorur ende në makineri p.sh vidhat, dadot dhe bulonat të jenë të vlerësuara saktësisht si stoqe të materialeve harxhuese (indirekte) brenda pasurive qarkulluese.

### **Furnitorët jashtë vendit**

Pasi që furnitori është i ri, mund të nodhë se nuk ekzistojnë kontrollet mbi regjistrimin e transaksioneve në valutë të huaj.

Rreziku i vetvetishëm është i lartë pasi që llogaritë e pagueshme duhet të jenë të shëndrruara duke përdorur vitin dhe normën e këmbimit sipas SNK/IAS 21 Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit.

Nëse nuk është kryer kjo gjatë vitit, të pagueshmet tregtare do të jenë dukshëm të mbivlerësuara ose të nënvlerësuara, varësisht nga lëvizjet e euros në dollar në mes të datës së blerjes dhe fundit të vitit. Komponentet duhet të mbesin me kosto historike brenda vlerësimit të stoqeve dhe nuk duhet të ri-përkthehen në fund të vitit në atë valutë.

### **Provizionet për garancitë**

Provizionet për garancitë janë materiale me 2.6% të pasurive totale (2006 - 2.7%).

Provizionet janë rritur vetëm për €100,000, një rritje prej 4.2%, krahasuar me rritjen e të hyrave prej 21.4%. Kjo do të shkaktojë një nënvlerësim të provizioneve pasi që ndryshimi në përqindjen e provizioneve duhet të jetë në përputhje me ndryshimin në përqindjen e shitjeve, vetëm nëse janë bërë përmirësime të dukshme në kualitetin e makinerive të instaluar të klientët gjatë këtij viti.

Kjo duket të mos ketë gjasa duke patur të dhënë dëmin ligjor nga Sali dhe makineria e instaluar te Arti shpk. Duke operuar pa efikasitet baza e vlerësimit mund të jetë e nënvlerësuar për të evituar rritjen në provizione si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave. Kjo paraqet një brengë kryesore pasi që shefi ekzekutiv dhe shumica e aksionarëve janë ata cilët vlerësojnë provizionet për garancitë.

### **Shumica e aksionarëve**

Armendi ka kontroll mbi DIG shpk me shumicën e aksioneve të tij dhe duke qenë drejtor ekzekutiv i kësaj kompanie. Kjo dukshëm rrit rrezikun që pasqyrat financiare përmbajnë anomali p.sh mbivlerësimi i pasurive, nënvlerësimi i detyrimeve dhe mbivlerësimi i fitimit.

Ky rrezik është i rëndësishëm në këtë fund të vitit pasi që ai është duke shpresuar t'i shesë disa aksione të DIG shpk pas fundit të vitit. Kjo vë re rezultat i asaj pasi që çmimi që ai merr për përfitimet e tij personale do të rritet duke u ndikuar nga pozita financiare e kompanisë më 30 nëntor 2020 dhe ka interes në manipulimin e pasqyrave financiare për qëllimet e përfitimeve personale. Për shembull:

Mos njohja e provizioneve ose detyrimeve kontingjente për dëmet ligjore ndaj Sali.

Mos paraqitja e llogarive të arkëtueshme të shlyera nga Arti.

Mos rritja e provizioneve për garancitë

Njohja e të hyrave më heret sesa që lejohet nga *SNRF 15*.

### **Transaksionet e palëve të lidhura**

Armendi kontrollon DIG shpk dhe poashtu ka kontroll mbi Pacifik shpk. Transaksionet në mes të këtyre dy kompanive duhet të shpalosen sipas *SNK 24 Shpalosjet e Palëve të Lidhura*. Ekziston rreziku se nuk janë shpalosur të gjitha transaksionet ose që një transaksion është shpalosur me vlerë jo të saktë. Detajet e kontratës së lizingut në mes të dy kompanive duhet të shpalosen në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare në vecanti shumat të cilat DIG shpk i detyrohet Pacifik shpk më 30 nëntor 2020.

### **Çështjet tjera**

Armendi dëshiron që auditimi të përfundojë sa më shpejtë të jetë e mundur, e cila e bën më heret afatin e fundit për përfundimin e auditimit. Skuadra e auditimit mund të mos ketë kohë të mjaftueshme për t'i përfunduar të gjitha procedurat e nevojshme ose nuk do të ketë kohë të mjaftueshme për të bërë rishikimet adekuate të punës së kryer. Rreziku i moszbulimit dhe rreziku i auditimit do të rritet dhe kualiteti i tërësishëm i auditimit mund të jetë i rrezikuar.

Kjo është me rëndësi pasi që është viti i parë i auditimit dhe skuadra e auditimit do të punojë me duke u mësuar më shpejtë. Procedurat e auditimit mund të marrin më shumë kohë se sa është planifikuar dhe për këtë nuk ka kohë të zgjaten procedurat aty ku është e nevojshme.

Armendi mund të ketë ndikim të konsiderueshëm në anëtarët e skuadrës së auditimit për të siguruar se pasqyrat financiare do të paraqesin pozitën më të mirë të mundshme të DIG shpk me qëllim të shitjes së aksioneve të saj. Është thelbësore që anëtarët e skuadrës së auditimit tu përmbahen udhëzimeve etike dhe pavarësia e tyre nuk duhet të vihet në diskutim.

Për shkak të seriozitetit të çështjeve të përmendura më lartë, një çështje përfundimtare e cila duhet të kihet parasysh gjatë planifikimit është që rishikimi i partnerit sekondar (Rishikimi i Kontrollit të Cilësisë së Angazhimit) duhet të merret në konsiderim gjatë auditimit të këtij viti. Duhet të identifikohet një rishikues i pavarur si dhe koha e planifikuar dhe e buxhetuar për përfundimin e detyrave.

### Detyra 3

Rekos operon një zinxhir të pikave të shitjes me pakicë në të gjithë vendin. Kompania punëson 260 personel të përhershëm dhe fundi i vitit të raportimit të saj financiar është 30 nëntor 2019. Ju jeni senior i i auditimit i RMK, i cili ka audituar Rekos për disa vite. Tani po shikoni fushën e pagave dhe të pagueshmeve tregtare.

#### Pagat

Në Rekos, personeli i përhershëm punon një numër standard të orëve në javë, siç përcaktohet në kontratën e tyre të punës. Sidoqoftë, kur pikat e shitjes me pakicë janë të ngarkuara, stafi mund të kërkohet nga menaxhmenti të punojë ndërrime shtesë si punë jashtë orarit. Kjo ose mund të paguhet në baza mujore ose të merret si pushim.

Koha shtesë regjistrohet manualisht, dhe paga bruto dhe neto që rezulton për secilin punonjës llogaritet automatikisht nga sistemi i pagave. Pagat rriten nga shkalla e inflacionit çdo vit dhe nëpunësit e pagave janë përgjegjës për azhurnimin e të dhënave të përhershme në sistemin e pagave.

Punonjësit paguhet në baza mujore me transfer bankar për orët e tyre të kontraktuara javore dhe për çdo punë shtesë të punuar në muajin e mëparshëm, kur është e zbatueshme. Programi i pagave prodhon një listë të pagesave për punonjës; kjo ndërvepron me sistemin bankar për të prodhuar një listë të pagesave automatike.

Rekos zbrit tatimet dhe pensionet nga pagat në baza mujore dhe i paguan këto tek autoritetet e tatimore në muajin vijues. Në fund të vitit, pasqyrat financiare do të përfshijnë një shpenzim aktual për tatimin mbi të ardhurat e pagueshme për të pagat.

#### Informacion shtese:

Rekos punëson 25 menaxherë të shitjes me pakicë dhe në zyra, 200 staf të shitjes me pakicë dhe 35 staf zyre. Shtrirja e pagës për secilën kategori tregohet më poshtë:

Menaxherë me pakicë dhe zyra: €35,000 - €50,000 për vit

Stafi me pakicë dhe zyra: €18,000 - €25,000 për në vit

Të gjithë stafit iu dha një rritje page prej 4% gjatë vitit, e datuar në fillim të vitit financiar.

Një menaxher u largua në gjysmën e vitit financiar dhe 15 punonjës të rinj me pakicë dhe zyra u bashkuan në gjysmën e vitit.

Shpenzimi i pagave në draft pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 30 nëntor 2019 është €6,795,400.

#### Llogaritë e pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare në draft Pasqyrën e Pozicionit Financiar të Rekos janë si më poshtë:

	2019	2018
Llogaritë e pagueshme	884,824	816,817

#### Kërkohet:

(a) Numëroni dhe shpjegoni procedurat thelbësore të auditimit që duhet të kryhen gjatë auditimit përfundimtar për të konfirmuar plotësinë dhe saktësinë e shpenzimeve të pagave të Rekos.

Ju lutemi, injoroni tatimin e pagueshëm në të ardhurat pasi kjo është përfshirë në pjesën (b) më poshtë. (6 pikë)

(b) Identifikoni procedurat e auditimit të kërkuara në lidhje me shpenzimin aktual të fundvitit për tatimin e pagueshëm mbi të ardhurat personale. (4 pikë)

(c) Kryeni një procedurë thelbësore analitike për të fituar komoditet mbi shpenzimet totale të pagave dhe për të shpjeguar procedurat e auditimit të kërkuara për t'u mbështetur në llogaritjen. (7 pikë)

(d) Përshkruani procedurat thelbësore të auditimit që duhet të kryhen në auditimin e llogarive të pagueshme tregtare për vitin e mbyllur më 30 nëntor 2019. Për secilën procedurë, shpjegoni qëllimin e kësaj procedure, përfshirë pohimet përkatëse. (8 pikë)

[Gjithsej: 25 pikë]

## Zgjidhja

### (a) Procedurat thelbësore të listës së pagave:

- Rillogaritni një mostër të regjistrave të pagave për të konfirmuar që shpenzimet e pagave janë llogaritur siç duhet.
- Përputhni shpenzimet totale të pagave të regjistruara në sistemin e pagave në bilancin e vërtetues dhe hetoni çdo ndryshim.
- Krahasoni shpenzimet totale të pagave me shifrën e vitit paraprak; bisedoni me menaxhmentin për arsyt e ndonjë ndryshimi të rëndësishëm.
- Krahasoni shpenzimet mujore të pagave dhe krahasoni këto me buxhetin dhe me shpenzimet përkatëse të muajit në vitin paraprak. Bëni pyetje të menaxhmentit në lidhje me arsyt për ndonjë ndryshim të rëndësishëm.
- Kryeni një provë në total të kostove të pagave, duke marrë parasysh punonjësit e rinj dhe ata që u larguan dhe rritjen e pagave.
- Për një mostër të punonjësve, rillogaritni pagën bruto dhe neto, dhe krahasoni këtë me regjistrat e pagave.
- Për një mostër të punonjësve, rillogaritni përfitimet dhe llogaritjet e zbritjeve ligjore; përputhni tatimin e zbritur në deklaratat tatimore.
- Për një mostër të personave të punësuar të rinj dhe të larguar gjatë vitit, dakordoni datën e fillimit ose datën e largimit të tyre sipas regjistrave të pagave në regjistrat e BNJ për të siguruar që pagat janë llogaritur për periudhat e sakta. Përputhni një mostër të personave të punësuar të ri në regjistrat e BNJ me listën e pagave, për të kontrolluar për plotësinë.
- Për një mostër të punonjësve, përputhni me shpenzimet e pagave në regjistrat e BNJ për të siguruar që është zbatuar normë e saktë e pagave.
- Për një mostër të personave të punësuar të rinj dhe të larguar gjatë vitit, rillogaritni pagën e tyre për muajin e parë / të fundit për të konfirmuar saktësinë.
- Krahasoni pagesat totale të bëra sipas listës së transferimeve bankare me pagën totale neto në regjistrat e pagave për të siguruar që të gjithë punonjësit e paguar janë regjistruar përmes listës së pagave.
- Për një mostër të pagesave të orëve shtesë, përputhni me kohën shtesë të paguar nga fletët javore të orarit shtesë në regjistrat e pagave për të konfirmuar plotësinë.

### (b) Procedurat e auditimit në lidhje me tatimin e pagueshëm për të ardhurat personale:

- Inspektoni korrespondencën me autoritetet tatimore për të konfirmuar shumën e papaguar të pagesave. (Bilanci në fund të vitit normalisht do të përfaqëson zbritjet e një muaji). Verifikoni shumën e papaguar në regjistrat e pagave.
- Gjurmoni pagesat e tatimeve nga libri i parave të gatshme në pasqyrat bankare.
- Përputhni tatimin e pagueshëm me shpenzimet e pagueshme të pagave për të konfirmuar saktësinë.
- Për një mostër të punonjësve, rikryeni llogaritjen e zbritjes së tatimeve për të konfirmuar saktësinë.
- Rishikoni shpalosjet e bëra për përlllogaritjen e tatimit mbi të ardhurat dhe përcaktoni nëse ato përputhen me standardet dhe legjislacionin e kontabilitetit.

Menaxherët	€
Paga mesatare	42,500
Zbatimi i 4% rritje në vit	44,200
Gjithsej paga mesatare (25-0.5=24.5 menaxherë)	1,082,900
Stafi	

Paga mestare	21,500
Zbatimi i 4% rritje në vit	22,360
Gjithsej paga mesatare (235+7.5 = 242.5 staf)	5,422,300
Shpenzimi i pritur i pagave	6,505,200
Shpenzimi i pagave sipas PF	6,795,400
Ndryshimi	290,200
	4.27%

Meqenëse diferenca është më pak se 4.27%, konsiderohet se nuk është një ndryshim material. Sidoqoftë, në mënyrë që të mbështetemi në procedurën thelbësore analitike, është e rëndësishme të jemi të kënaqur me të dhënat që po përdorim në llogaritjen.

Ne do të duhet të sigurohemi për sa vijon:

- Përputhni pagat e stafit me kontratat e punës.
- Përputhni numrat e stafit me raportet e pagave. Përzgjedhni një mostër të punonjësve nga raportet e pagave dhe përputhni me kontratat e punës për t'u siguruar që ato ekzistojnë.
- Përputhni rritjen prej 4% në paga me korrespondencën me shkrim të punonjësit.

<b>Procedurat thelbësore</b>	<b>Arsyeja e testit</b>
Kryeni procedurat analitike mbi llogaritë e pagueshme, duke i krahasuar me saldot fillestare. Hetonimë tutje nëse ka diferenca.	Për të konfirmuar arsyeshmërinë e shifrës në PF
Përzgjedhni një mostër të LLP për ti tesuar me tutje, duke i përputhur shumat me dokumentet mbështetëse siç janë faturat dhe urdhërblertjet dhe pagesat pas fundit të vitit. Fokusoni mostrën në saldo material, por përfshini të zëra me saldo edhe më të ulët.	Për të konfirmuar saktësinë e shumave të njohura në PF dhe përfshirjen e tyre të saktë si detyrime në PF e fundvitit.
Përputhni një mostër të zërave nga lista e të pagueshmeve me librin kryesor	Për të konfirmuar plotësinë dhe ekzistencën e LLP
Përputhni totalin e listët së LLP dhe përputhni shifrat me sistemin e kontabilitetit	Për të konfirmuar plotësinë e shumave
Merrni kartelat e furnitorëve për një mostër të furnitorëve dhe harmonizoni me saldot përfundimtare në librin kryesor	Për të konfirmuar vlerësimin, plotësinë dhe ekzistencën e shumës së detyrimeve në fund të vitit.
Për një mostër të faturave të blerjes të regjistruara para fundit të vitit, përputhni me fletëpranimet përkatëse për të konfirmuar se mallrat janë pranuar para fundit të vitit	Për të konfirmuar se është bërë prerja e duhur
Për një mostër të fletëpranimeve para fundit të vitit, ndjekni ato deri te faturat e blerjes dhe sigurohuni se janë regjistruar para fundit të vitit	Për të konfirmuar se është bërë prerja
Për një mostër të fletëpranimeve para fundit të vitit ndjekni ato deri te faturat e blerjes dhe sigurohuni se janë postuar para fundit të vitit	Për të konfirmuar se është bërë prerja
Për një mostër të debive në listën e LLP, merrni shpjegime nga stafi i klientit	Për të konfirmuar se është bërë shpalosje e duhur në LLP

#### Detyra 4

(a) Ju jeni një menaxher auditimi në firmën e auditorëve J&J i cili ofron një sërë shërbimesh auditimi dhe shërbimesh të tjera të sigurisë për klientët e saj. Një nga klientët tuaj të auditimit është Nana ShPK e cila operon si kompani tregtare transporti. Nana ka qenë klient auditimi për pesë vitet e fundit dhe aktualisht po planifikon një zgjerim të rëndësishëm të operacioneve të saj në një zonë të re gjeografike dhe juridiksion. Në mënyrë që të financojë zgjerimin e planifikuar, Nana ka nevojë për fonde për të blerë automjete të tjera të rënda, për të zgjeruar pajisjet e saj të magazinimit dhe për të rekrutuar më shumë shoferë. Kompania po planifikon gjithashtu një fushatë të madhe reklamuese dhe marketingu drejtuar klientëve të mundshëm në juridiksionin e ri. Drejtori i financave të Nana, Syzana Fusha, ju është drejtuar për t'ju pyetur nëse firma juaj do të ofrojë një raport mbi informacionin e ardhshëm financiar i cili është përgatitur në mbështetje të një kërkesë kredie. Aplikimi është për një hua të re afatgjatë prej 22 milion Euro nga huamarrësi aktual i kompanisë të cilën ajo synon të përdorë ekskluzivisht për të financuar zgjerimin e planifikuar. Kompania aktualisht ka një hua afatgjatë ekzistuese prej 31 milion Euro nga e njëjta bankë e cila mund të shlyhet në pesë vjet. Syzana ju ka siguruar ekstraktin e mëposhtëm nga informacioni i ardhshëm financiar i cili do të jetë pjesë e aplikimit të kompanisë për kredi:

Pasqyrat e parashikuara të të ardhurave:

	Shënimi	31 gusht 2018	31 gusht 2019	31 gusht 2020
		Të paaudituar	Parashikim	Parashikim
Të hyrat	1	138,861	174,965	225,705
KMSH	2	(104,862)	(124,786)	(157,230)
Shpenzime administrative	3	(22,936)	(21,984)	(20,743)
Fitimi operativ		11,063	28,195	47,732
Kosto e financimit	4	(1,450)	(1,638)	(1,597)
Fitimi para tatimit		9,613	26,557	46,135

#### Shënime:

1. Të hyrat përfaqësojnë shumat që rrjedhin nga ofrimi i shërbimeve transportuese për klientët komercialë që veprojnë kryesisht në sektorin e shitjes me pakicë. Bordi i drejtorëve të Nana beson se tregtia si në tregjet ekzistuese ashtu edhe në ato të reja do të përjetojë rritje të konsiderueshme gjatë dy viteve të ardhshme.
2. Kostoja e shitjeve përfshin kostot e magazinimit dhe shpërndarjes përfshirë kostot përkatëse të stafit, mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve dhe zhvlerësimin e pronës, pajisjeve dhe automjeteve.
3. Shpenzimet administrative janë kryesisht kostot e menaxhmentit të zyrave qendrore të Nana.
4. Kostot e financimit përfaqësojnë koston e interesit të kredive afatgjata nga bankat e Nana.

#### Kërkohet:

- (i) Shpjegoni çështjet që duhet të merren parasysh nga J&J përpara se të pranoni angazhimin për rishikim dhe për të raportuar mbi informacionin e ardhshëm financiar të Nana. (6 pikë)
- (ii) Duke supozuar se J&J pranon angazhimin, rekomandoni procedurat e ekzaminimit që duhet të kryhen në lidhje me paasqyrat e parashikimit të të ardhurave të Nana. (9 pikë)

(b) SNA 450 Vlerësimi i anomalive të identifikuara gjatë auditimit përshkruan përgjegjësitë e auditorit në vlerësimin e efektit të anomalive të identifikuara.

#### Kërkohet:

Përkufizoni 'anomalitë e pakorrigjuara' dhe shpjegoni përgjegjësitë e auditorit lidhur me anomalitë e pakorrigjuara. (5 pikë)

Sol

(a) Nana Shpk

(i) Çështjet që duhet të merren parasysh para pranimit të angazhimit

Kur merret parasysh pranimi i angazhimit për të rishikuar informacionin e ardhshëm financiar (IAF) të Nana Shpk, J&J duhet të konsiderojë nëse është etikisht e pranueshme të kryejë rishikimin. Rishikimi i IAF përfaqëson një shërbim jo për siguri dhe Kodi i Etikës IESBA për Kontabilistët Profesionistë (Kodi) thotë që ofrimi i këtij shërbimi përveç auditimit mund të krijojë një kërcënim avokimi. Një kërcënim për avokim paraqitet kur auditorit i kërkohet të promovojë ose përfaqësojë klientin e tij në një farë mënyre. Në këtë situatë ekziston rreziku që auditori të shihet sikur promovon interesat e klientit me një palë të tretë siç është një bankë. Si rezultat, ekziston rreziku që auditori të jetë i njëanshëm në favor të klientit dhe për këtë arsye nuk mund të jetë plotësisht objektiv. Pranimi i angazhimit mund të krijojë gjithashtu një kërcënim të interesit vetjak si rezultat që auditori perceptohet se ka interes në rezultatin e negociatave me një palë të tretë dhe që mund ta motivojë auditorin të sillet në mënyrë që të mbrojë atë interes. Një kërcënim i vetë-rishikimit mund të paraqitet gjithashtu sepse negociatat mund të rezultojnë në fakte dhe shuma të cilat do të jenë pjesë e pasqyrave financiare të audituara. Si rezultat, auditori do të auditojë pasqyrat financiare të cilat pjesërisht të paktën përfaqësojnë punën që ata vetë kanë kryer. Nga kjo rrjedh se ekziston rreziku që auditori të mos jetë mjaft objektiv në kryerjen e auditimit dhe mund të dështojë të identifikojë ndonjë mangësi në punën e tyre. Në rastin e Nana, kërcënimi i avokimit duket të jetë veçanërisht domethënës pasi firma e auditimit mund të shihet se po promovon interesat e klientit të auditimit në bankë. Prandaj, auditori duhet të pranojë angazhimin vetëm nëse mund të vendosen masa mbrojtëse adekuate për të menaxhuar kërcënimin ndaj pavarësisë në një nivel të pranueshëm.

Masat mbrojtëse të mundshme mund të përfshijnë sa vijon:

- Përdorimi i ekipeve të veçanta të personelit me përvojë të përshtatshme për auditimin dhe rishikimin e IAF;
- Rishikimi i pavarur i letrave të punës së IAF;
- Diskutimi i çështjeve të mundshme etike dhe kërcënimet ndaj pavarësisë së auditorit me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen në Nana. Duhet të theksohet, megjithatë, se nuk do të ishte e mundur të menaxhohej një kërcënim i rëndësishëm avokimi përmes masave të tilla mbrojtëse dhe në një rast të tillë emërimi nuk duhet të pranohet. ISAE 3400 Ekzaminimi i Informacionit të Ardhshëm Financiar ofron udhëzime të mëtejshme në lidhje me çështjet që auditori duhet të marrë parasysh përpara se të pranojë një angazhim për të ekzaminuar IAF. Sipas ISAE 3400, auditori duhet të marrë në konsideratë ndër të tjera:
  - Përdorimi i synuar i informacionit - për shembull, nëse do të përdoret vetëm për qëllimet e financimit të propozuar të huasë;
  - Nëse informacioni do të jetë për shpërndarje të përgjithshme ose të kufizuar - auditori duhet të marrë parasysh se kush do ta marrë raportin dhe potencialisht të mbështetet në të;
  - Natyra e supozimeve, domethënë, nëse ato janë supozime më të mirat ose hipotetike - në këtë rast duket e mundshme që ato do të jenë supozime më të mira të vlerësimit pasi Nana pret të marrë financim në mënyrë që të financojë zgjerimin e saj të planifikuar;
- Elementet që duhet të përfshihen në informacion
- Jansen & Co duhet të sqarojë përmbajtjen e saktë të IAF për të cilën po kërkohet të raportojnë, për shembull, nëse përfshin vetëm deklaratat e parashikimit të fitimit ose humbjes ose nëse përfshin gjithashtu deklaratat e parashikimit të pozicionit financiar dhe rrjedhën e parashikuar të parave; dhe
- Periudha e mbuluar nga informacioni - parashikimet afatshkurtra kanë gjasë të jenë më të besueshme sesa parashikimet për një periudhë më të gjatë. J&J gjithashtu duhet të konsiderojë nëse firma ka staf të mjaftueshëm në dispozicion me aftësitë dhe përvojën e duhur për të kryer angazhimin e rishikimit në përputhje me afatet e kërkuara të raportimit të klientit. Në

përgjithësi, auditori duhet të vlerësojë rreziqet që lidhen me angazhimin e rishikimit dhe nuk duhet të pranojë një angazhim kur supozimet janë qartësisht joreale ose kur auditori beson se informacioni i ardhshëm financiar do të jetë i papërshtatshëm për përdorimin e tij të synuar.

(ii) Procedurat e ekzaminimit:

- Duhet të konfirmohet saktësia aritmetike e pasqyrave parashikuese të fitimit ose humbjes;
- Konfirmimi që politikat e kontabilitetit të përdorura në pasqyrat e parashikimit janë në përputhje me ato të përdorura në pasqyrat financiare të audituara dhe se ato janë në përputhje me SNRF;
- Diskutoni supozimet kryesore që janë bërë nga klienti në përgatitjen e paqyrave të parashikimit me menaxhmentin duke vlerësuar arsyeshmërinë dhe qëndrueshmërinë e tyre me njohuritë kumulative të firmës së auditimit dhe kuptimin e klientit;
- Rishikimi i dokumentacionit të hulumtimit të tregut në tregjet ekzistuese të Nana dhe tregut të ri dhe diskutimi i tij me menaxhmentin për të vlerësuar nëse modelet e rritjes që parashikohen në të ardhura përfaqësojnë pritje të arsyeshme dhe reale;
- Merrni kopjet e çdo kontrate të re të klientëve për tregjet ekzistuese dhe ato të reja për të konfirmuar arsyeshmërinë e rritjes së parashikuar të të ardhurave.
- Merrni një përfaqësim me shkrim nga menaxhmenti që konfirmon arsyeshmërinë dhe plotësinë e supozimeve që ata kanë bërë në përgatitjen e parashikimeve;
- Duhet të vlerësohet kompetenca dhe përvoja e stafit të klientit që kanë përgatitur parashikimet; vlerësimi duhet të përfshijë saktësinë e IAF që është përgatitur në periudhat e mëparshme dhe arsyet për ndonjë ndryshim të rëndësishëm krahasuar me rezultatet aktuale;
- Rillogaritja e zhvlerësimit për të siguruar përfshirjen e saktë të zhvlerësimit në pronat dhe pajisjet e magazinimit brenda pasqyrave të parashikimit;
- Merrni dhe rishikoni një ndarje të shpenzimeve operative për të siguruar që të gjithë zërat janë përfshirë siç duhet, për shembull: shpenzimet e reklamimit dhe marketingut për fushatën në juridiksionin e ri; kosto shtesë të stafit për drejtuesit e rinj duke përfshirë shpenzimet e rekrutimit; çdo tarifë tregtare që ka të bëjë me operimin në tregun e ri dhe çdo implikim në valutë;
- Faturat e fundit të shërbimeve duhet të inspektohen dhe të bëhet një vlerësim i arsyeshmërisë së shpenzimeve të përgjithshme të shërbimeve;
- Merrni dhe rishikoni dokumentacionin mbështetës për marrëveshjet ekzistuese të huasë me bankën, si dhe draft dokumentacionin për huanë e re; kostot e parashikimit të financimit duhet të rillogariten dhe të bien dakord me pasqyrat e parashikimit;
- Kryerja e procedurave analitike, pasuar nga diskutimi me menaxhmentin për të kërkuar prova vërtetuese të tendencave dhe raporteve kryesore duke përfshirë:
  - Rritja e të ardhurave (26% nga 2018 në 2019; 29% nga 20X9 në 2020)
  - Kostoja e shitjeve si përqindje e të ardhurave (75.5% në 2018; 71.3% në 2019; 69.7% në 2020)
  - Trendi në rënie i shpenzimeve administrative (ulje prej 4.2% nga 2018 në 20X9; 5.6% nga 2019 në 2020)
  - Rritja në marzhin e fitimit neto (6.9% në 2018; 15.2% në 2019; 20.4% në 2020).

#### b) Anomalia e pakorrigjuara

Një anomali e pakorrigjuar është anomali e akumuluar gjatë auditimit nga auditori i cili nuk është korrigjuar nga kompania.

Si pjesë e procedurave të përfundimit të auditimit, auditori duhet të konsideroj nëse totali anomalive të pakorrigjuara në pasqyrat financiare është materiale, pasi që është llogaritur dhe konfirmuar materialiteti. Gjatë përcaktimit nëse anomalitë e pakorrigjuara janë materiale (individialisht ose të grumbulluara), auditori duhet të konsiderojë madhësinë dhe natyrën e anonalive dhe efektin e tyre në pasqyrat financiare të periudhave të mëparshme.

Auditori duhet të komunikojë anomalitë e pakorrigjuara të personave të ngarkuar me qeverisjen.  
Auditori gjithashtu duhet të kërkojë përfaqësime të shkruara nga menaxhmenti nëse ata besojnë se efekti i anomalive të pakorrigjuara është jomaterial.